



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: **AN&RA shpk**

Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga Fortuzi, Godina Nr. 33, Hyrja 1, Apartamenti 6.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedure e Hapur e Thjeshtuar**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-98175-06-15-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Blerje materiale të buta për nevoja të Konvikteve të Shkollave të Mesme**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): **Buletini i Njoftimeve Publike Nr.95, date 21.06.2021**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” shpk NUIS-K22218003V

Vlera totale e ofertës pa TVSH = **2.670.000 (dymilion e gjashtëqind e shtatëdhjetëmijë) lekë.**

2. Operatori ekonomik “GENTIAN SADIKU” shpk NUIS-L42314005A

Vlera totale e ofertës pa TVSH = **2.698.000 (dymilion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë) lekë.**

3. Operatori ekonomik “AN&RA” shpk NUIS-K12205001I

Vlera totale e ofertës pa TVSH = **2.692.500 (dymilion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e peswqind) lekë.**

4. Operatori ekonomik “SHAGA” shpk NUIS-J96822229J

Vlera totale e ofertës pa TVSH = **2.680.000 (dymilion e gjashtëqind e tetëdhjetëmijë) lekë.**

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” shpk NUIS-K22218003V

Arsyet e skualifikimit sa më poshtë:

Ne procesin e dorezimit të mostrave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatohet se operatori ekonomik Atlantik 3 nuk ka paraqitur mostrat për procedurën objekt prokurimi duke mos plotësuar "Kriteret e vecanta për kualifikim", Kapaciteti teknik, pika 2.3.6 ku citohet:

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin 2 mostra fizike (produkt i gatshëm) për të gjitha mallrat objekt prokurimi sipas preventivit. Mostrat duhet të jenë të dallueshme të qepura me penj të kuq dhe të kenë të qepur një etiketë e cila të përmbajë "emrin e artikullit", "datën e zhvillimit të tenderit", emrin e prodhuesit/importuesit", "nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues".

- **Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, me adresë: Rruga "Jeronim De Rada", pranë shkollës Teknike Ekonomike, Tiranë**
- Çdo mostër e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.
- **Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim.**

Gjithashtu pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik "Atlantik 3" shpk ka paraqitur deklaratat dhe formularin e ofertes sipas shtojces 1 duke mos marrë në konsideratë deklaratat dhe formularët sipas dokumentave standarte të tenderit miratuar me vendim Nr.3, date 09.06.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik "Për miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra, pune, shërbime për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur e thjeshtuar".

Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", pika 1, germa b përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 54.160 (pesëdhjetë e katërmijë e njeqind e gjashtëdhjetë) lekë, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave konstatohet se se operatori ekonomik "Atlantik 3" shpk nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes duke mosplotësuar "Kriteret e vecanta të kualifikimit", pika 1, germa b

2. Operatori ekonomik "GENTIAN SADIKU" shpk

NUIS-L42314005A

Arsyet e skualifikimit sa më poshtë:

- I. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", Kapaciteti Teknik, pika 2.3.4 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:**

2.3.4. Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **4 (katër) punonjës** për periudhën **Mars 2021 - Maj 2021**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Mars 2021 - Maj 2021**.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Mars 2021 - Maj 2021**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se operatori ekonomik ka vetdeklaruar se nuk disponon numrin minimal të punonjësve pasi në formularin e vetdeklarimit ka deklaruar se disponon punonjës të siguruar 1 (nje) duke mosplotësuar kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor ku specifikisht

percaktohet qe operatori ekonomik duhet te kete jo me pak se 4 punonjes te siguruar per periudhen Mars 2021 - Maj 2021 dukemos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik pika 2.3.4

3. Operatori ekonomik "SHAGA" shpk

NUIS-J96822229J

Arsyet e skualifikimit sa më poshtë:

I. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", Kapaciteti Teknik, pika 2.3.6 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin 2 mostra fizike (produkt i gatshëm) për të gjitha mallrat objekt prokurimi sipas preventivit. Mostrat duhet të jenë të dallueshme të qepura me penj të kuq dhe të kenë të qepur një etiketë e cila të përmbajë "emrin e artikullit", "datën e zhvillimit të tenderit", emrin e prodhuesit/importuesit", "nënshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik ofertues".

- **Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes se ofertave pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, me adresë: Rruga "Jeronim De Rada", pranë shkollës Teknike Ekonomike, Tiranë**
- Çdo moster e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.
- **Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim.**

Nga komisioni i vleresimit të ofertave i mbledhur në datën dhe orën e hapjes së ofertave për të verifikuar mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomike konstatohet se operatori ekonomik "Shaga" shpk nuk ka paraqitur mostrat për procedurën objekt prokurimi duke mos plotësuar Kriteret e veçanat për kualifikim, Kapaciteti teknik pika 2.3.6.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik AN&RA shpk, me adresë Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga Fortuzi, Godina Nr. 33, Hyrja 1, Apartamenti 6 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 2.692.500 (dymilion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e pesëqind) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".